

Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit për gjykata ("Gazeta zyrtare e RM" nr.58/2006...96/2019), neni 68 të Rregullores gjyqësore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 66/2013), dhe neni 41 të Rregullores së punës të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 13/1998 dhe 21/2009), në seancën e mbajtur me datë 29.06.2020, miratoi siç vijon:

M E N D I M J U R I D I K

Nuk mund të kërkohet kthimi i shumës në emër të kompensimit të dëmit për shkak të lëndimit trupor, përkeqësimit të shëndetit ose vdekjes, kur pagesa është bërë në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm ngase pagesa është realizuar nga furnizues i ndërgjegjshëm, gjë që nuk është nën ndikim ajo që në procedurën e revizionit i dëmtuari është refuzuar në atë pjesë të kërkesë padisë.

A r s y e t i m

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë duke vendosur në procedurë për revizion konstatoi praktikë gjyqësore të pabarabartë gjatë zbatimit të nenit 205 të Ligjit për marrëdhëniet obliguese dhe pyetjen juridike "kur mund të mbahet e pranuar" në procedurat e përfitimit pa bazë, respektivisht në raste kur personave të dëmtuar në bazë të aktgjykimeve të plotfuqishme gjyqësore u është paguar kompensim i dëmit për shkak të lëndimit trupor, përkeqësimit të shëndetit ose vdekjes, ndërsa aktgjykimet e procedurave për revizion kanë qenë të ndryshuara dhe është përcaktuar shumë më e ulët për kompensimin e dëmit ose kërkesë padia është refuzuar si e pa bazë dhe baza në bazë të së cilës është realizuar pagesa ka dështuar.

Çështja juridike e cila është vendimtare për zbatimin e drejtë të nenit 205 të Ligjit për marrëdhënie obliguese është konstatimi i "përgjegjësisë së furnizuesit të mjeteve".

Sipas rregullit të përgjithshëm, të shënuar në nenin 199 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie obliguese ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 18/2001... 161/2009), kur një pjesë e pronës së një personi kalon në çfarëdo mënyrë në pronën e një personi tjetër, e ai kalim nuk ka bazë të vetin në ndonjë çështje juridike ose në këtë ligj, përfituesi është i detyruar ta kthejë atë pjesë të pronës, nëse është e mundshme, ndërsa gjithsesi është i detyruar të kompensojë vlerën e interesit të arritur. Sipas paragrafit 3, detyrë për kthimin, respektivisht për kompensimin e vlerës ndodh edhe kur diçka pranohet duke marrë parasysh bazën që nuk është realizuar ose që më vonë ka dështuar.

Sipas nenit 205 nga i njëjti ligj, titulli i të cilit thirret "kur mund të mbahet e pranuar", nuk mund të kërkohet kthimi i shumave të paguara pa bazë në emër të kompensimit të

dëmit për shkak të lëndimit trupor, përkeqësimit të shëndetit ose vdekjes, nëse pagesa i është realizuar furnizuesit të përgjegjshëm.

Sipas nenit 314 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 79/2005...124/2015), kur palës në aktgjykim i urdhërohet që të realizojë ndonjë bërje do të përcaktohet afati brenda të cilit është detyruar që ta realizojë ta bëjë këtë bërje.

Sipas nenit 374 nga i njëjti ligj, revizioni i parashtruar nuk e mban ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm kundër të cilës është deklaruar.

Nga përmbajtja e nenit 205 të Ligjit për marrëdhënie obliguese rrjedh se, e heq obligimin për kthimin e shënuar në nenin 199 nga i njëjti ligj në rast kur baza të mos jetë realizuar ose e njëjta më vonë ka dështuar, kusht për atë është pagesa e kompensimit të shumave të paguara pa bazë në emër të kompensimit të dëmit për shkak të lëndimit trupor, përkeqësimit të shëndetit ose vdekjes, nëse ishte realizuar për furnizuesin e përgjegjshëm.

Vallë, furnizuesi i shumave të paguara pa bazë, ka qenë i përgjegjshëm në momentin e furnizimit të tyre kur pagesa është realizuar në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm.

Nga përmbajtja e dispozitave të nenit 314 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë kontestuese rrjedh detyrë e palës të cilës i nënshtrohet ndonjë veprim, të njëjtën ta realizojë në afatin e caktuar në aktgjykim, por në qoftë se nuk e bën atë pala në favor të së cilës është sjellë aktgjykimi, mund ta kërkojë atë në mënyrë detyruese.

Në qoftë se, merret parasysh përmbajtja e nenit 374 të Ligjit për procedurë kontestuese, se revizioni i parashtruar nuk e mban ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm kundër të cilës është deklaruar, rrjedh se paditësi ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për realizimin e dëmshpërblimit të shqiptuar plotfuqishëm në qoftë se i padituri në afatin e lënë vullnetarisht nuk e bën vet atë, ashtu që pranimi i revizionit e pastaj pagesa për kërkesën e dëmshpërblimit të shqiptuar plotfuqishëm përmes përbaruesit nga ana e tij, nuk tregon papërgjegjësinë e tij për shkak se ai pagesën për kërkesën e dëmshpërblimit e ka realizuar në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm gjyqësor dhe ekzekutues. Nga këtu, në këtë rast i padituri në procedurën e përfitimit pa bazë konsiderohet si furnizues i përgjegjshëm, ndërsa pikërisht ajo është arsyeja që e përjashton të drejtën e paditësit të kërkojë kthimin e shumave të paguara pa bazë për kompensimin e dëmit për shkak të lëndimit trupor, përkeqësimit të shëndetit ose vdekjes.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**